



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 546, datë 05.11.2020

PËR
KOMANDIMIN NË SKEMËN E DELEGIMIT TË GJYQTARIT Z. SOKOL PINA

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 45 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të kërkesës së gjyqtarit z. Sokol Pina, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së gjyqtarit z. Sokol Pina.
2. Komandimin e gjyqtarit z. Sokol Pina në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në një vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.
3. Përfundimin e gjyqtarit z. Sokol Pina nga procedurat e shortit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.
4. Gjyqtari i skemës së delegimit, z. Sokol Pina, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, për të cilat ka përfunduar apo është në përfundim hetimi gjyqësor.
5. Efektet juridike të vendimit fillojnë data e njoftimit.
6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. Sokol Pina sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR